

Organizimi

Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor është struktura kryesore që ofron mbështetjen institucionale për zbatimin e politikave zhvillimore të kërkimit shkencor. Kjo drejtori dhe sektorët vartës janë përgjegjës për ndjekjen e politikës së kërkimit, programet, prioritetet, grantin e ofruar, shpërblimet, produktivitetin e KSH në nivel njësie kryesore, publikimet, si dhe bashkëpunimet rajonale dhe ndërkombëtare. Këto veprimtari ofrojnë kornizën për përcaktimin e strukturave përgjegjëse kryesore, në nivel institucioni dhe njësie akademike, të organizuara si më poshtë:

1. Zv. Rektori për Shkencën dhe Projektet:

- Ndjek dhe kontrollon veprimtarinë shkencore të Universitetit;
- Nxiti dhe ndjek gjithë projektet dhe programet shkencore në të cilat merr pjesë Universiteti;
- Bashkërendon veprimtarinë shkencore të Universitetit me institucionet e tjera shkencore, njësitë qeveritare dhe komunitetin;
- Ndjek dhe mbështet ecurinë e kualifikimit shkencor të personelit akademik;
- Ndjek ecurinë e buletinit shkencor, revistave shkencore dhe konferencave që organizohen nga UK-ja;
- Nxiti integrimin e studentëve në projekte shkencore;
- Nxiti përfshirjen e projekteve shkencore në procesin e mësimdhënies;
- Bashkërendon dhe kontrollon gjithë veprimtarinë e personelit ndihmësakademik në varësi në nivel institucioni.

2. Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor

DKSCK-ja ndjek në tërësi problemet dhe detyrat që lidhen me:

- hartimin, organizimin dhe zbatimin e programeve të reja të studimit dhe çështje që lidhen me zbatimin e detyrave të lëna nga ASCAL-i, si dhe me monitorimin e cilësisë së zbatimit të kurrikulës në cikle të ndryshme të studimit;
- mbarëvajtjen e veprimtarive të përgjithshme kërkimore në institucion, mbikëqyrjen e procedurës së aplikimit dhe menaxhimit të projekteve kërkimore dhe hartimin e planit strategjik të nevojshëm për mbarëvajtjen e punës kërkimore e botuese.

3. Sektori i Projekteve, Kërkimit Shkencor dhe Botimeve

Kjo zyrë është përgjegjëse për koordinimin e procedurave, analizave dhe veprimtarive të ndryshme kërkimore në nivel institucioni. Ky sektor mbikëqyr organizimin e veprimtarive, seminareve dhe takimeve nëpërmjet komunikimit interaktiv dhe koordinon marrëdhëniet me fakultetet, personelin dhe institucionet e jashtme, sipas nevojës së veprimtarive kërkimore-shkencore. Ai ndjek veprimtaritë shkencore në nivel fakulteti, duke ofruar asistencë teknike sipas nevojës. Gjithashtu, kjo zyrë është qendra e të gjitha veprimtarive, procedurave dhe shërbimeve administrative në lidhje me stafin kërkimor, për të siguruar ecuri funksionale dhe operative, sipas rregullave administrative dhe akteve të brendshme të UK-së. Zyra i

përgjigjet kërkesave dhe nevojave të shprehura nga çdo njësi akademike për veprimtari kërkimore, shkencore e botuese.

4. **Njësia për organizimin e veprimtarive kërkimore shkencore në nivel njësie kryesore:** Kjo njësi është përgjegjëse për përpunimin dhe analizën e projektpropozimeve të ardhura nga njësitë bazë, përmes aplikimit të procedurave standarde që përfshijnë vlerësimin e fushës kërkimore, ndjekjen dhe miratimin e fondeve.
5. **Grupi për menaxhimin dhe koordinimin e veprimtarive kërkimore-shkencore:** Ky grup i ngritur në nivel njësie bazë menaxhon dhe koordinon veprimtaritë shkencore e kërkimore mes anëtarëve të njësisë dhe studentëve, ndjek ecurinë e zbatimit të projekteve fituese dhe mbikëqyr procedurat për performancën e përgjithshme të departamentit në lidhje me projektet, rezultatet, produktivitetin, cilësinë dhe ndikimin e publikimeve. Grupi është përgjegjës për të shprehur pranë Njesisë së organizimit të veprimtarive shkencore në fakultet nevojat e departamentit dhe të studentëve të programeve që mbulon ky departament për tekste dhe botime ndihmëse.